



REPUBLICA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**SKEMË VLERËSIMI
 QYTETARI - PSIKOLOGJI**

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1 B 1 pikë

Pyetja 2 2 pikë

Model përgjigjeje:

- E drejta e pronës (private/publike);
- Të drejtat në bashkëpronësi (ligjore/me vullnet të lirë/ortakëri);
- Të drejtat që rrjedhin nga Kontrata: qeraje/shit-blerje/huaje bankare;
- E drejta e trashëgimisë (ligjore/testamenti/dhurimi);
- Të drejta civile si e drejta e emrit, caktimit lirshëm të banesës, etj.

Shënim: Nxënësi merr pikë edhe nëse e konkretizon përgjigjen me shembull.

2 pikë nëse shkruan saktë dy kategori;
1 pikë nëse shkruan saktë një kategori;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Pyetja 3 D 1 pikë

Pyetja 4 2 pikë

Model përgjigjeje:

Në Republikën e Shqipërisë sovraniteti i përket popullit. Ai e ushtron sovranitetin e tij në këto dy mënyra:

- drejtpërsëdrejti kur zgjedhësit marrin vendim për një çështje të rëndësishme, p.sh nëpërmjet referendumit;
- nëpërmjet përfaqësuesve të tij në Kuvend mes zgjedhjeve periodike lokale apo të përgjithshme.

2 pikë nëse identifikon dy mënyra të ushtrimit të sovranitetit;

1 pikë nëse identifikon një mënyrë të ushtrimit të sovranitetit;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 C 1 pikë

Pyetja 6 B 1 pikë

Pyetja 7 2 pikë

Model përgjigjeje:

- a) Të drejtat civile dhe politike janë ato të drejta që mbrojnë lirinë e individit nga shtrëngimet e qeverive, organizatave apo individëve. Ato mundësojnë pjesëmarrjen e individit në jetën civile dhe politike të shoqërisë.
- b) Të drejtat për mjedisin dhe zhvillimin kanë të bëjnë me sigurimin e kushteve për mbrojtjen nga dëmtimi apo nga shkatërimi i hapësirës natyrore jetësore të njeriut.

2 pikë nëse përshkruan saktë kategorinë a) edhe b);
1 pikë nëse përshkruan saktë kategorinë a) ose b);
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8 B 1 pikë

Pyetja 9 2 pikë

Model përgjigjeje:

- Njohja, respektimi dhe zbatimi i rregullores së shkollës;
- Kujdesi për të marrë mjetet shkollore të domosdoshme për orën e mësimi;
- Respektimi i orarit;
- Frekuentimi i rregullt i procesit mësimor;
- Përgjegjësia për mirëmbajtjen e mjediseve dhe mjeteve shkollore;
- Respektimi i figurës së mësuesit dhe personelit shkollor;
- Respektimi i nxënësve të tjerë, etj.

2 pikë nëse shkruan dy përgjegjësi;
1 pikë nëse shkruan një përgjegjësi;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 C 1 pikë

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje:

Shteti:

- harton bazën ligjore për mbrojtjen e shëndetit të çdo qytetari duke hartuar ligje specifike.
- ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në mjediset përkatëse;
- informon për ruajtjen nga rreziqet që u kanosen qytetarëve dhe mënyrat e parandalimit të tyre;
- garanton të drejtën e qytetarëve për shëndet.

2 pikë nëse shkruan dy aspekte nga mbrojtja;

- 1 pikë** nëse shkruan një aspekt nga mbrojtja;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Parimi- "Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm"

Analiza- ky parim kërkon marrjen e vendimeve që të plotësohen nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes, pa prekur mundësitë edhe për brezat e ardhshëm që të plotësojnë nevojat e tyre.

- 2 pikë** nëse identifikon dhe analizon domethënien e këtij parimi;
1 pikë nëse identifikon **OSE** analizon domethënien e këtij parimi;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **B** **1 pikë**

Pyetja 14 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Legjislacioni parashikon:

- riparimin e mallit;
- zëvendësimin e mallit;
- uljen e çmimit të paguar;
- anulimin e kontratës.

Shënim: Nxënësi merr pikë edhe nëse e konkretizon përgjigjen me shembull.

- 2 pikë** nëse shkruan dy aspekte nga legjislacioni;
1 pikë nëse shkruan një aspekt nga legjislacioni;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Ligji kërkon të parandalojë:

- cënimin e edukimit;
- dëmtimin e zhvillimit të tij fizik;
- dëmtimin e shëndetit mendor, shpirtëror ose moral;
- cënimin e lirisë;
- pengimin e procesit të shoqërizimit me moshatarët.

- 2 pikë** nëse identifikon dy nga pasojat e mësipërme;
1 pikë nëse identifikon një nga pasojat e mësipërme;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **D** **1 pikë**

Pyetja 17 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

Këshilla që një drejtues i biçikletës duhet të zbatojë për sigurinë vetjake gjatë qarkullimit në rrugë:

- të mos mbajë pasagjerë në biçikletë;
- të respektojë sinjalet rrugore;
- të mos varet pas një mjeti motorik në lëvizje;
- të përdorë korsinë e caktuar;
- të mbajë timonin të paktën me një dorë;
- të mos ngasë biçikletën nën efektin e alkoolit, drogës;
- etj.

2 pikë nëse shkruan dy nga këshillat e mësipërme;

1 pikë nëse shkruan një nga këshillat e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Pyetja 18 **C** **1 pikë****Pyetja 19** **2 pikë****Model përgjigjeje**

Për t'u përdorur në rubrikën "lajm", informacionet duhet të jenë:

- të reja;
- të panjohura më parë;
- të lidhura me jetën e publikut, fatet e njerëzve;
- të lidhura me ngjarje tronditëse - fatkeqësitë natyrore, luftërat etj.

2 pikë nëse shkruan dy nga tiparet më sipër;

1 pikë nëse shkruan një nga tiparet më sipër;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Pyetja 20 **D** **1 pikë****Pyetja 21** **C** **1 pikë****Pyetja 22** **C** **1 pikë**

Pyetja 23 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

- Presioni;
- Ndryshimet jetësore;
- Konfliktet;
- Frustrimi;
- Shqetësimet e përditshme;
- Ngjarjet katastrofike , tërmetet, përmbytjet etj.

- 3 pikë** nëse identifikon tri nga shkaqet e mësipërme;
- 2 pikë** nëse identifikon dy nga shkaqet e mësipërme;
- 1 pikë** nëse identifikon një nga shkaqet e mësipërme;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

- a) Kërkimi korrelues.
- b) Veçoritë janë:

- përdoret si në natyrë dhe në laborator;
- mbledh shumë informacion në kohë të shkurtër;
- studiohen shumë ndryshore njëkohësisht;
- bën parashikime të sakta.

- 3 pikë** nëse identifikon kërkimin korrelues dhe dy nga veçoritë e kërkimit mësipër;
- 2 pikë** nëse identifikon kërkimin korrelues dhe një nga veçoritë e kërkimit mësipër;
- OSE**
- 2 pikë** nëse identifikon dy nga nga veçoritë e kërkimit mësipër;
- 1 pikë** nëse identifikon kërkimin korrelues **OSE** një nga nga veçoritë e kërkimit mësipër;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

- a) Truri i prapmë kontrollon funksionet bazë jetësore të trupit si frymëmarrja dhe rrahja e zemrës.
- b) Zona motorike transmeton informacion që drejton kryesisht lëvizjet e vullnetshme te muskujt skeletor.
- c) Lobi parietal është përgjegjës për interpretimin e ndijimeve të tilla si prekja, dhimbja, temperatura.

- 3 pikë** nëse shpjegon saktë funksionin përkatës për të trija kërkesat;
- 2 pikë** nëse shpjegon saktë funksionin përkatës për dy nga kërkesat;
- 1 pikë** nëse shpjegon saktë funksionin përkatës për një nga kërkesat;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26 A 1 pikë

Pyetja 27 A 1 pikë

Pyetja 28 B 1 pikë

Pyetja 29 3 pikë

Model përgjigjeje:

- Njeriu ka synim zhvillimin e plotë të të gjithë potencialit të tij.
- Njeriu vepron për të përmbushur nevojat e veta si ato biologjike, për siguri, dashuri, nevojat për vlerësim dhe vetaktualizim. Këto nevoja vënë në lëvizje energjine psikike.
- Njeriu është i mirë dhe pozitiv por bëhet i keq kur e pengojnë që të tregojë anën e mirë.

3 pikë nëse shkruan tri aspekte të shpjegimit sipas teorisë humaniste;

2 pikë nëse shkruan dy aspekte të shpjegimit sipas teorisë humaniste;

1 pikë nëse shkruan një aspekt të shpjegimit të teorisë humaniste;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 A 1 pikë

Pyetja 31 D 1 pikë

Pyetja 32 C 1 pikë

Pyetja 33

Model përgjigjeje:

a) 1 pikë

Kujtesa afatgjate.

1 pikë nëse identifikon kujtesën afatgjate;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) 3 pikë

Përbërësit bazë të kujtesës janë:

- Kodimi sipas kuptimit (kodim semantik);
- Depozitimi i informacionit për kohë pa limit;
- Riprodhimi (sa më i organizuar sipas kategorive, aq më lehtë për t'u bërë).

OSE

Kujtesa afatgjatë		
Deklarative(faktet)		Procedura(aftësitë)
Semantike	Episodike	

3 pikë nëse identifikon tre përbërës bazë;

2 pikë nëse identifikon dy përbërës bazë;

1 pikë nëse identifikon një përbërës bazë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 34 B 1 pikë

Pyetja 35 B 1 pikë

Pyetja 36

Model përgjigjeje:

a) 1 pikë

Qëndrimi është një prije e natyrshme për të ndier, për të menduar dhe për të vepruar në mënyra të caktuara përkundrejt një klase njerëzish, objektesh apo ideje.

1 pikë nëse përcakton qëndrimin si më sipër;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) 3 pikë

Faktorë që ndikojnë në formimin e qëndrimeve tona:

- kushtëzimi veprues - vlerësimet dhe lavdërimet që marrim kur shprehim qëndrime të caktuara dhe anasjelltas ndëshkimet për shkak të qëndrimeve të tjera./ Ne mësojmë nga përforcimet ose ndëshkimet në jetë;
- të mësuarit përmes vëzhgimit apo imitimit - (p.sh veshja në nënyrë të ngjashme me miqtë etj.);
- kultura e shoqërisë në të cilën ne rritemi, njerëzit me të cilët shoqërohemi ndikojnë në zhvillimin e qëndrimeve tona;
- prindërit, të cilët ndikojnë duke shprehur qëndrimet e tyre në prezencën tonë dhe ne ato qëndrime që përsëriten, i marrim të gatshme;
- shokët, bashkëmoshatarët, kolegët e punës etj. gjithashtu ndikojnë në qëndrimet tona;
- media, sidomos personazhet realë apo mediatikë që kanë status të lartë i shohim si modele për t'u ndjekur.

3 pikë nëse analizon ndikimin e tre faktorëve në formimin e qëndrimeve tona;

2 pikë nëse analizon ndikimin e dy faktorëve në formimin e qëndrimeve tona;

1 pikë nëse analizon ndikimin e një faktori në formimin e qëndrimeve tona;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
